



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Drejtoria Juridike, Komunikimit dhe Prokurimeve
Sektori i Transparencës dhe Komunikimit

Lënda: *Minutat e takimit nga diskutimi i publikut për projektvendimin “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”*

Ditën e hënë datë 20.04.2015, në ambjentet e Ministrisë së Mjedisit u zhvillua dëgjesa e publikut për projektvendimin “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve”.

Në këtë takim merrnin pjesë këta përfaqësues të Shoqërisë Civile:

Z. Arian Sauku nga Mileukontatkt;
Znj. Teida Shehi, Co-Plan
Znj. Lira Hakani, EDEN
Znj. Odeta Jahaj, Universiteti GRAZ
Znj. Rita Strakosha, përfaqësuese e Ekolëvizjes
Z. Qerim Ismeni, nga Shoqata MZHQR
Z. Gëzim Dapi, ekspert
Z. Eduart Cani, organizata REC Albania

Nga Ministria e Mjedisit morën pjesë këta përfaqësues:

Znj. Ledijana Karalliu, shefi i sektorit të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Aksidenteve Industriale.
Z. Polikron Horeshka sektori i Menaxhimit të Mbetjeve dhe Aksidenteve Industriale.
Znj. Edlira Dersha, specialiste, Sektori i Transparencës dhe Komunikimit;

Dëgjesa u hap nga znj. Ledjana Karalliu, e cila ju shpjegoi të pranishmë rëndësinë e kësaj dëgjese për të ndihmuar procesin e hartimit të këtij Vendimi të Këshillit të Ministrave, si një akt që do përcaktonte qartë rregullat për mbajtjen dhe përditësimin e statistikave për mbetjet n sesi do të mblidheshin të dhënat në fushën e mbetjeve.

Më pas prezantimin për këtë draft Vendim të Këshillit të Ministrave e bëri z. Polikron Horeshka, i cili është miratimi i rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave të mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe ministria.

Gjithashtu ai shpjegoi se në këtë draft Vendim të Këshillit të Ministrave dhe veçanërisht në shtojcën e hartuar paraqitet saktë se cilat janë institucionet qendrore dhe lokale, që do raportojnë të dhënë në mënyrë të përvitshme sipas formatit që gjëndet në shtojcën bashkangjitur draftit të VKM-së. Pas prezantimit fjala ju dha të pranishmëve për të bërë Komentet e tyre.

Z. Gëzim Dapi, ngriti shqetësimin e tij në lidhje me nenin që specifikonte se “Ministria përgjegjëse për mjedisin, mbi bazën e të dhënave të ardhura nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, përgatit dhe publikon në variantin elektronik dhe në ëbsite-in e ministrisë çdo 3 vjet nga hyrja në fuqi të këtij vendimi, raportin 3- vjeçar për statistikën e mbetjeve në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe ia vë në dispozicion publikut” (neni 3, pika 4).

Z. Dapi mendonte që ishte e papërshtatshme që vetëm 1 herë në tre vjet do kishte një raportim mbi sasinë e mbetjeve sipas tabelave të hartuara në Shtojcën bashkalidhur vendimit.

Z. Horeshka tha që raportimet do publikohen nga Agjencia si dhe Bashkitë në çdo një vit. Ndërsa në çdo tre vjet do jetë një raport analitik i situatës nga Ministria e Mjedisit.

Së dyti z. Dapi shprehu shqetësimin e tij në lidhje me mënyrën se si do i mbledhin të dhënat bashkitë, pasi deri tani ka qënë subjektive aaaa ka ndonjë metodologji që parashikon formën dhe mënyrën që bashkitë do mundësojnë këtë sistem statistikor që po i kërkohet nga Ju.

Zoti Horeshka tha se brënda 2016, bashkitë do bëjnë ndarje në burim gjë që do të mundësojë dhe prodhimin e saktë të të dhënave sipas shtojcës së hartuar.

Znj. Rita Strakosha, propozoi që në draft të të saktësohej që publikimi i të dhënave do të bëhet çdo vit dhe nga kush institucion do të bëhet. Gjithashtu ajo pyeti nëse ka sanksion të parashikuar për autoritetet që nuk raportojnë për këto të dhëna.

Z. Horeshka saktësoi se ka parashikime penalizime për institucionet që nuk japin të dhënat e kërkuara.

Znj. Teida Shehu, pyeti nëse do ketë një filtër për të parë vlefshmërinë e të dhënave që jepen nga institucionet lokal?

Z. Horeshka e siguroi që këtë proces do e kryente Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Më pas e mori fjalën **z. Ismen Qerimi**, i cili sygjeroi të shihej dhe njëherë shtojca e për zërat e mbetjeve që duhej raportuar pasi i dukej shumë e fryrë

duke sjellë si shëmbull zërin për sasinë mbetjeve bimore dhe shtazore të pakompostuar, apo për sasinë e mbetjeve të krijuara nga druri duke thënë që këto në vetvete nuk ishin mbetje. Kjo gjë thjesht vështirëson punën e specialistëve të cilët do ju duhet të raportojnë këtë sasi mbetjesh.

Z. Horeshka tha që shtojca është ndërtuar mbi kërkesën që Shqipëria ka për të raportuar në konventa të ndryshme, të cilat i ka ratifikuar.

Z. Eduart Cani, së pari propozoi të ndryshohet objektivi i draftit, pasi objektivi i vendosur është shumë i gjërë dhe në vetvete nuk qëndron ashtu siç thuhet që ...Objekti i këtij vendimi, është përcaktimi i një kuadri ligjor në rregullat....”, pasi nuk përcakton kuadrin ligjor. Siç shihet nga përmbajtja ai mundëson përcaktimin e sistemit të të dhënave në fushën e mbetjeve.

Së dyti duhet parë nëse mundet që më këtë draft Vendim të kërkohet krijimi i sistemit të statistikave në nivel vendor në këtë fushë, pasi kjo do i hapte përmbushjes së detyrimeve që kërkon ky draft Vendim.

Gjithashtu do ju këshilloja që të shikoni futjen e afateve kohore të ndryshme për të dhëna të ndryshme që kërkohen të realizohen përmes këtij vendimi, “pasi të jemi koshient për realitetin vetëm pak të dhëna nga zërat e mbetjeve monitorohen për momentin” tha z. Cani “ Të jemi koshient që edhe Bashkia e Tiranës që është më e madhja në vend nuk parashikon deri në 2016 ndarjen sipas rrymave të mbetjeve, por ka parashikuar vetëm zgjerimin e venddepozitimit në Sharrë” .

Takimi u mbyll duke i ftuar të pranishmit nga shoqëria civile, se nëse do kishin komente t’i nisnin ato elektronisht në adresën zyrtare të Ministrisë së Mjedisit info@moe.gov.al .